



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 01.07.2013

Nr. 0201-692

**Për:** Blerim Kuçi, Kryetarë i Komunës së Suharekës

**Lënda:** Përgjigje në Kërkesë

I nderuari Kryetar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar kërkesën për konsultim paraprak lidhur me paraqitjen e konfliktit të mundshëm të interesit në procesin e zhvilluar të tenderimit, lidhur me projektin e partneritetit publik-privat, ku fitues i tenderit është një familjar i kryetarit aktual të komunës së Suharekës.


Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Rregulloren Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ligjit për Parandalimit e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik Nr. 04/L-051, pas shqyrtimit të shkresës, konstaton se:

- Bazuar në nenin 59.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Kryetari i Komunës përjashtohet nga procedurat vendimmarrëse dhe administrative që kanë të bëjnë me ndonjë çështje, në të cilën ai apo ndonjë anëtarë i familjes së tij, ka interes personal apo financiar;
- Për rastin në fjalë Kryetari i Komunës përjashtohet nga e drejta e formimit të komisionit për vlerësimin e ofertave dhe nënshkrimin të kontratës, marr parasysh se përzgjedhjen e kompanisë e bënë komisioni për vlerësimin e ofertave, atëherë konflikti i interesit paraqitet nëse Kryetari i Komunës ka themeluar komisionin.
- Me rastin e përjashtimit të kryetarit nga procesi vendimmarrës për shkak të konfliktit të mundshëm të interesit nënshkrimin e kontratës e bënë Nënkryetari i Komunës bazuar në nenin 60.3 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

MAPL, në vazhdimësi është e përkushtuar të ofrojë përkrahje dhe ndihmën e nevojshme komunave të Republikës së Kosovës, për zbatimin e plotë të obligimeve, që dalin nga legjislacioni i zbatueshëm për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**  
**Zëvendës Kryeministër & Ministër i MAPL,**



**Kopje:** Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së  
Udhëheqësve të Departamenteve në MAPL  
Arkivit të MAPL-së.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datum: 01.07.2013  
Br. 0201-692

**Za :** Blerim Kuçi, Gradonačelnik Opštine Suva Reka

**Predmet:** Odgovor na zahtev

Poštovani Gradonačelnice,

Ministarstvo administracije Lokalne je podnelo zahtev za pretodnu konsultacie u vezi sa konfliktom interesa u proceu razvoja tendera,u vezi sa javno privatnim projektom,gde je dobitnik tendera jedan rodjak aktualnog gradonačelnika Opštine Suva Reka.


Ministarstvo administracije Lokalne samouprave na osnovu nadležnosti i odgovornosti odredjenih po Zakonu za lokalnu samoupravu Br. 03/L-040, Uredbom Br. 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, Zakonu o Sprečavanju Konflikta Interesa u Vršenju Javne Funkcije br. 04/L-051, po razmatranju zahteva, konstatuje:

- Na osnovu člana 59.2 Zakona br. 03/L-040 za Lokalnu samoupravu, Gradonačelnik Opštine se isključuje od procedura donošenja odluka i administrativnih koja se tiču pitanja u kojem on ili neki član njegove porodice , ima lični ili finansijski interes ;
- U navedenom slučaju Gradonačelnik Opštine se isključuje od prava formiranja komisije za procenjivanje ponuda i potpisivanja ugovora , imajući u vidu da izbor kompanije vrši komisija za procenjivanje ponuda , onda je konflikt interesa ako je Gradonačelnik Opštine osnovao komisiju.
- Prilikom isključivanja gradonačelnika iz procesa donošenja odluke zbog mogućeg konflikta interesa potpisivanje ugovora vrši podpredsednik opštine, bazirano na član 60.3 Zakona br. 03/L-040 za Lokalnu samoupravu.

MALS, je opredeljeno da ponudi podršku i potrebnu pomoć opštinama Republike Kosovo, za potpuno sprovođenje obavaza, koja proizilaze od sprovedljivog zakonodavstva za lokalnu samoupravu u Republiku Kosovo.


S poštovanjem,

**Slobodan Petrović,**  
**Zamanik Premijera & Ministar MALS,**



*Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a  
Rukovodiocima Uprava MALS-a  
Arhivu MALS-a*



		REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E SUHAREKËS OPSTINE SUVA REKA			
		28.05.2013			
REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA		REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA		REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
DËRGUAR - DOSTAVLJENO - SENT					
Nr. Br. No.	Data Datum Date	Sella Sedište Hq	Adresa Adresa Adress		
01	28.05.2013	Suharekë	Prishtinë		
				Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministrarshtro e Lokale Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration Data Datum 29.05.2013 Date	
				Niveli organizativ Nr i Lëndës Shitja Vlera - III - 0201-692	

PËR/ZA/TO:	z. Slobodan Petroviç-Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushteti Lokal në Prishtinë.
CC:	z. Besnik Osmani-Sekretar i Përhershëm në MAPL-në
PËRMES/PREKO/THROUGH	
NGA/OD/FROM:	Blerim Kuçi-Kryetar i Komunës në Suharekë
LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për konsultim paraprak
DATE/A:	28 maj 2013



Te nderuar,

Me anë të kësaj shkrese Ju njoftojmë se Kryetari i Komunës, Blerim Kuçi, konform dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr-03/L-040, publikuar në (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, në menyrë vullnetare e paraqes konfliktin e ineresit dhe e prejashtoj veten nga vendimmarrja në procedurat e tenderit, për projektin me titull "SHËRBBIMET PËR GRUMBULLIMIN E MBËTURINAVE NË KOMUNËN E SUHAREKËS" ky projekt është zhvilluar përmes PARTNERITËT PUBLIKO PRIVAT, në këtë proceduar ka konkuruar edhe firma "Victoria Invest" SHPK me seli në Suharekë me pronar Fatmir Kuçi, e cila është fituese e tenderit me kushte me të volitshme dhe çmim më të lirë, mirëpo kontrata ende nuk është nënshkruar.

**Kontrate që parashihet të nënshkruhet ka një afat të gjatë prej 10, vite me mundësi të vazhdimit edhe për 2.5, vite.**

Andaj kërkojmë nga Ju që konform nenit 83, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisje lokale që të na këshilloni apo rekomandoni për procedurat të më tutjeshme ligjore se kush ka të drejt ta nënshkruan kontratën, apo ta zëvendëson nënshkrimin e Kryetarit të Komunës.

Bashkangjitur keni; Deklaratën e Kryetarit të Komunës, për paraqitjen e konfliktit të interesit

Shpresojmë së kërkesa jonë do të hasë në mirëkuptim!

Me respekt

Kopje;  
MAPL-së  
Arkiva

28.05.2013

# DEKLARATË

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUHAREKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MATRE NË DORËZIM PRIMIJE - RECEIVED			
Niveli org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Bilj. Number	Shprehja Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	16	3956	2

Duke u bazuar në neni 59 pika 2, 3 dhe 4, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr-03/L-040, publikuar në (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008) dhe nenin 46, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, unë Blerim Kuçi-Kryetar i Komunës në Suharekë në menyrë vullnetare e paraqes konfliktin e interesit dhe e prejashtoj veten nga vendimmarrja në procedurat e tenderit, për projektin me titull "SHËRBIMET PËR GRUMBULLIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E SUHAREKËS" ky projekt është zhvilluar përmes PARTNERITETIT PUBLIKO PRIVAT, në këtë proceduar ka konkuruar edhe firma "Victoria Invest" SHPK me seli në Suharekë me pronar Fatmir Kuçi, e cila është fituese e tenderit me kushte me të volitshme dhe çmim më të lirë, mirëpo kontrata ende nuk është nënshkruar.

Me pronarin e kësaj firme unë Kryetari i Komunës jamë në afërsi gjaku, përkatsisht e kamë djalë të axhës (kushërirë).

Me datë 27.05.2013



Kryetari i Komunës  
 \_\_\_\_\_  
 Blerim Kuçi